

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën viti 2012-2013 dhe me zgjedhje viti 2011 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimet e Kryetarit të KLSH-së nr. 76, datë 30.06.2014 dhe nr. 85, datë 14.07.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresat nr. 11/17, datë 30.06.2014 dhe nr. 11/21, datë 14.07.2014 si dhe nr. 11/16, datë 30.06.2014 dhe 11/20, datë 14.07.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Drilon Bushati, Kryetar i Degës Doganës, Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

A1. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Gjatë vitit 2013 janë konstatuar procedura zhdoganimi për artikuj me origjinë nga vendet e EU të klasifikuara në kodin tarifor 23099031 sipas deklaratave me numrat respektiv R 51388, datë 29.8.2013; R 2073, datë 17.01.2013; R 31036, datë 30.5.2013; R 63144, datë 18.10.2013; R 40255, datë 10.7.2013; R 11129, datë 01.3.2013; R 21971, datë 19.4.2013; R 39357 dhe një deklaratë e vitit 2012 me numër R 39357, datë 4.7.2012 të cilat nuk përfshihen në zhdoganim me taksë doganore në bazë të NK të Mallrave.

Nga auditimi rezulton që sipas përshkrimit të artikullit në faturat respektive, artikulli në këto deklarata doganore duhej të klasifikohej në kodin tarifor 23091090 për të cilat duhet të aplikohet taksë doganore në masën 10 % në bazë të NK të Mallrave. Nga auditimi rezulton gjithashtu që janë marrë mostra për tu analizuar në Laboratorin Doganor me qëllim saktësimin e kodit tarifor por që deri në datën 22.4.2014 që ka përfunduar auditimi në Degën e Doganës, Tiranë dhe është dërguar projektraporti i auditimit nuk kishte përgjigje nga Laboratori Doganor. Në këto kushte janë llogaritur dhe diferencat monetare për deklaratat e mësipërme në shumën 4,621,389 lekë (detyrime doganore + penalitete).

Nga Dega e Doganës, Tiranë argumentohet që klasifikimi i produktit në kodin tarifor 23099031 është bërë në përputhje me klasifikimin në deklaratën shoqëruese të mallit i cili është në varësi të përmbajtjes së disa elementëve ushqimor në produkt si dhe janë paraqitur përgjigjet nga Laboratori Doganor me shkresë nr. 677/6, datë 20.5.2014 certifikatat e verifikimit të mallit dhe klasifikimit tarifor me numër 1377, 1378 datë 20.5.2014 ku në përfundim të analizave i klasifikon në kodet tarifore shtatë shifrore 2309 904 që, në kushtet e origjinës preferenciale, tarifa që i korrespondon është 0 %. Nga ana tjetër subjektet e biznesit, të cilëve ju perkasin deklaratat e sipërcituara, deklarojnë që artikullin e kanë deklaruar sipas klasifikimit në deklaratën shoqëruese të mallit, i janë nënshtruar kërkesave të autoritetit doganor duke afuar garanci në përmbushje të detyrimeve nga rivlerësimi i mundshëm, e cila është kthyer e plotë nga autoriteti doganor që vërteton se subjekti ka qenë në rregull me vetë deklarin.

Në bazë të kompetencës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duke u mbështetur në argumentimet sa më sipër, faktit që përgjigjet nga Laboratori Doganor mbërrijnë në doganë me mbi një vit vonesë dhe pretendimeve të subjekteve të biznesit, të verifikojë importet e këtij artikulli sipas deklaratave të cituara më sipër, të trajtuara në faqet nr. 111-113, 122 të

Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të marrë masa për përcaktimin e procedurave dhe unifikimin e tyre për importe të artikujve të kësaj natyre me qëllim që të zvogëlohet mundësia e subjektivizmit në klasifikimin tarifor në kode me tarifë 0 % për shmangie nga taksat doganore dhe rritur transparencën me subjektet e biznesit që operojnë në këtë fushë.

A2. Për Degën e Doganës, Tiranë

1. Dega e Doganës Tiranë ushtron aktivitetin në zonë doganore të miratuar me VKM nr. 722, datë 28.3.2013 i cili është shfuqizuar me VKM nr. 861, datë 30.9.2013. Dega e Doganës, Tiranë në bashkëpunim me DP të Doganave, duke ndjekur rrugët ligjore të marrë masa për miratimin e zonës doganore ku ushtron aktualisht aktivitetin, sipas kërkesave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 5, trajtuar në faqen nr. 193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Për detyrimet doganore nga zhdoganimi i automjeteve gjatë vitit 2012 nuk janë llogaritur e dokumentuar kamatëvonesat sipas dispozitave ligjore në fuqi. Nga Dega e Doganës, Tiranë të merren masa për llogaritjen dhe kontabilizimin e kamatëvonesave për detyrimet e debitorë për zhdoganim automjeteve për vendimet e periudhës së vitit 2012, të kryhen rakordimet periodike midis zyrës së borxhit dhe financës dhe të bëhet dokumentimi i rezultateve të tyre.

3. Për periudhën e audituar, zbatimi i urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga Gjykata, për vjeljen me forcë të borxhit doganor paraqitet në nivele të ulëta. Nga Dega e Doganës, Tiranë të merren masa që të bëhen efektive marrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive si dhe të rritet bashkëpunimi me Bankat e nivelit të dytë, QKR dhe Zyrat Përmbarimore me qëllim që të zbatohen plotësisht urdhrat e ekzekutimit për vjeljen me forcë të borxhit doganore.

4. Nga auditimi i deklaratave doganore për respektimin e afatit të regjimit të lejimit të përdorimit të automjeteve të importuara rezultojnë shkelje të afatit për 37 subjekte pas verifikimit nga sistemi TIM s dhe penaliteti i aplikuar për zhdoganimin e tyre nuk përputhet me kërkesat e KD si dhe për 8 subjekte të biznesit nuk është aplikuar penalitet pas përgjigjeve nga Laboratori Doganor për klasifikim tarifor jo korrekt. Nga Dega e Doganës, Tiranë të merren masa që duke respektuar afatet ligjore dhe vlerësuar mundësitë objektive për të kontaktuar të veprohet sipas procedurave ligjore në fuqi lidhur me rivlerësimin e deklaratave doganore për rikuperimin e shumës prej **3,335,755 lekë** nga 37 subjekte, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur, për automjetet e importuara për periudhën 2012 – 2013 dhe nga 8 subjekte për të cilat nuk është vepruar për penalizim, pas përgjigjeve nga Laboratori Kimik Doganor, për keq klasifikim të mallrave të pashoqëruar me efekte ekonomike, sipas aneksit nr. 2, 3 bashkëlidhur, trajtuar në faqet 167-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kërkuar nga Dega e Doganës Tiranë me shkresë nr. 20221/1, datë 19.11.2013 revokimin e vendimeve administrative për rimbursimin e akcizës në shumën 42,000,399 lekë të marra në kundërshtim me kriteret e ligjit nr. 61/2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika 5 e VKM nr. 128, datë 20.02.2013 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 19.04.2013 i ndryshuar, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të konstatuara nga auditimi i ushtruar për këtë qëllim nga Departamenti i Akcizës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Dega e Doganës, Tiranë nuk ka ndërmarrë veprime për revokim pasi konstatimi është bërë jashtë afateve ligjore dhe vendimet janë ekzekutuar. Për këtë qëllim ekziston një korrespondencë me DP të Doganave por problemi ende nuk ka marrë zgjidhje.

Në këto kushte Dega e Doganës, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike pranë DP të Doganave të marrë masa për fillimin e negociatave me subjektet dhe ndjekjen në rrugë gjyqësore duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për kthimin në buxhetin e shtetit të shumës prej prej **42,000,399 lekë** nga subjektet që janë rimbursuar në kundërshtim me kriteret e ligjit nr. 61/2002 “ Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika 5 e VKM nr. 128, datë 20.02.2013 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 19.04.2013 i ndryshuar, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, e kërkuar me shkresën nr. 20221/1, datë 19.11.2013, trajtuar në faqet 191-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Dosjet e subjekteve që kanë përfutur shtyrje të pagesës së TVSH-së rezultojnë pa inventar dhe administrohen disa prej tyre nga zyra e financës dhe pjesa tjetër nga sektori i regjimeve, si rrjedhim ndjekja e afateve nuk është e koordinuar. Nga sektori i regjimeve dhe financa të merren masa që dosjet e subjekteve që kanë përfutur shtyrje të pagesës për TVSH-në dhe në vijimësi, të inventarizohen dhe të arkivohen pranë Autoritetit Doganor Kompetent si dhe të rritet bashkëpunimi periodik midis tyre në drejtim të ndjekjes së afateve, likuidimit dhe llogaritjes së interesit për detyrimin e TVSH-së të pa paguar në afat, trajtuar në faqet nr. 152-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

7. Vendimet administrative të Autoriteti Doganor Kompetent, DD Tiranë, nuk marrin numër unik dhe datë, nuk administrohen në një database të veçantë si dhe të gjitha aktet (procesverbalet) ku mbështeten vendimet administrative nuk regjistrohen në librat e degës doganore. Me qëllim ndjekjen dhe monitorimin e tyre nga Dega e Doganës, Tiranë të merren masa për regjistrimin në librat e degës doganore të të gjitha akteve (procesverbale) të mbajtura nga sektorët mbi bazën e të cilave Autoriteti Doganor shprehet me vendime administrative si dhe të regjistrohen vendimet me numër unik dhe datë edhe në format elektronik, për sigurimin e gjurmës së auditimit dhe ndjekjen e monitorimin e pjesës ekzekutive të vendimeve, trajtuar në faqet nr. 167-171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Për periudhën e audituar dhe në vazhdimësi rezulton që praktikatat doganore të kenë të meta e kryesisht mangësi dokumentacioni sipas përcaktimeve të KD dhe VKM nr. 205, datë 13.05.1999 .

Nga Dega e Doganës, Tiranë, të merren masa që, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në KD, VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007:

- të plotësohen praktikatat doganore me dokumentacionin e nevojshëm si procesverbalet, aktverifikimet e ndryshme të mbajtura nga sektorët brenda degës doganore e nga sektorët e DPD si dhe amendimet e kryera brenda praktikës, dokumentacioni shoqërues i paraqitur për zhdoganim nga operatorët ekonomik të pranuar për vlerësim nga personeli doganor të mos jenë fotokopje si, fatura e shitjes, CMR, delarata e eksportit, certifikata e origjinës, parking lista, apo në raste të veçanta edhe Euro 1,

- të bashkëlidhen përgjigjet e laboratorit kimik doganor, Tiranë për klasifikimet e nevojshme tarifore të kryera dhe po të jetë se janë shoqëruar me vendimmarrje, të ketë bashkëlidhur procesverbalet e marrjes së mostrave dhe procesverbalin e mënyrës së asgjësimit të mostrave, të marra për klasifikimin tarifor të mallrave të importuar pasi nuk ka patur kontestime nga subjekti brenda afateve të parashikuara,

- të bashkëlidhet librezja e mjeti transportues, apo certifikata e peshimit bosh me qëllim përcaktimin e saktë të peshës bosh (tara) e mjetit, të kapacitetit mbartës të tij, si dhe të peshës

bruto e neto të mallit të importuar dhe eksportuar të pasqyruara në përlllogaritjen e shpenzimeve të transportit e të vlerës së mallit,

-në kuadratin “44” për qëllime doganore të pasqyrohen shpenzimet për sigurimin e mallit në udhëtim, kryesisht mallra të transportuara me destinacion nga Kina, USA, Kanada, Amerika e Jugut etj, të plotësuara me gjithë treguesit e specifikuar me të dhënat në kuadratet përkatëse të personelit doganor që ka përpunuar praktikën doganore dhe të pasqyrohet emër, mbiemër krahas nënshkrimit dhe vulës.

-të administrohet dhe arkivohet dosja e përgatitur me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm e të nevojshëm, me qëllim pranimin e çmimit me transaksion të faturës së shitjes në përlllogaritjen e vlerës doganore.

-të dorëzohen në arkiv me inventar të dokumentacionit përbërës pjesë e praktikës, me procesverbal dorëzimi dhe brenda 24 orëve nga përpunimi, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7726, datë 29.06.1993 “Për Arkivat” ndryshuar dhe me “Rregulloren mbi Ruajtjen e Administrimit të Dokumenteve në Administratën Shtetërore” si dhe me neni 12 të “Rregullores së Brendshme e Degëve Doganore dhe Drejtorive Rajonale” e miratuar me nr. 19095/2, datë 12.11.2012, trajtuar në faqet 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9. Në dosjet e subjekteve që operojnë në regjimin e magazinave fiskale nuk administrohen kalibrimet dhe certifikimet e pajisjeve që përdoren nga subjektet. Dega e Doganës, Tiranë të marrë masa për plotësimin e dosjeve të subjekteve që operojnë në regjimin e magazinës fiskale me kalibrimet dhe certifikimet e pajisjeve që përdoren nga subjektet në zhvillimin aktivitetit të tyre si dhe të rritet shkalla e monitorimit të veprimtarisë së subjekteve në terren në lidhje me dokumentimin dhe evidentimin e mallrave të akcizës sipas tarifave, kodit të mallrave dhe kontrollit direkt në magazinat fiskale, trajtuar në faqet nr. 124-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Nga Dega e Doganës, Tiranë, të hartohet një program pune për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” sidomos në përcaktimin e objektivave sipas prioriteteve, plan veprime konkrete për realizimin e objektivave, bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të institucionit dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij, këshillimin dhe dhënien e instruksioneve punonjësve të institucionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe rregullimin e veprimtarisë së Degës Doganore nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një rregullore të brendshme për kushtet specifike të degës si një nga dy degët që përballon volumn më të madh të përpunimit të informacionit dhe peshës që zë në të ardhurat nga sistemi doganor, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Brendshme të doganave nr. 19095/2, datë 12.11.2012, trajtuar në faqet nr. 192-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11. Duke qenë se nuk është parashikuar në strukturë përgjegjësi konkrete për koordinimin e veprimeve në drejtim të monitorimit të realizimit të planit të të ardhurave, nga Dega e Doganës, Tiranë të ngarkohet një punonjës për koordinimin e veprimeve midis zyrave dhe sektorëve në drejtim të ndjekjes dhe evidentimit në vazhdimësi dhe rregullisht të realizimit të planit të të ardhurave.

12. Nga Dega e Doganës, Tiranë, të ndërpritet shpërndarja e pakontrolluar e karburantit në formën e tollonave pa justifikuar shpenzimet e transportit dhe të merren masa që, në bashkëpunim me DP të Doganave, të bëhet e mundur sigurimi i mjeteve të transportit për transportimin e personelit doganor nga dega doganore me vendndodhje në Vorë në drejtim të

Tiranës dhe anasjelltas në kuadrin e ushtrimit të përgjegjësive institucionale si rakordime me institucione, kontrolle etj., trajtuar në faqen nr. 193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13. Nga Autoriteti Doganor Kompetent, DD Tiranë, të merren masa që Kontrolli Aposteriori dhe doganierët që kanë ndjekur regjimet e përpunimit aktiv, për diferencat e trajtuara në raport të rezultuara vetëm nga krahasimi i deklarimeve të subjektit me dokumentet e mbylljes së regjimit, të saktësojnë këto diferenca në ambientet e subjektit, nëpërmjet ballafaqimit me dokumentacionin kontabël të subjektit, duke analizuar shkaqet e nxjerrë përgjegjësinë dhe, mbi përfundimin, të llogariten detyrimet me destinacion të ri doganor, trajtuar në faqet nr. 130-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **68,143,006 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

7. Vlera prej **26,496,242 lekë**, nga 14 subjekte sipas trajtimit në faqet 152-162 të raportit për mos marrje vendim për detyrimin e papaguar në afat si dhe për mos llogaritje interesa për çdo ditë vonesë të pagesës së tvsh së shtyrë, në kundërshtim me VKM nr. 599, datë 16.08.2006 “Për skemën e shtyrjes së tvsh-së për makineritë e pajisje të importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH” i ndryshuar me VKM nr. 1674, datë 24.12.2008, UMF nr. 1, datë 26.09.2006 “Për zbatimin e skemës së shtyrjes së pagesës së tvsh” që përcakton VKM nr. 599, datë 16.08.2006” për periudhën 2011-2013 sipas aneksit nr. 10 bashkëlidhur raportit.

2. Vlera prej **11,163,412 lekë**, nga 50 subjekte sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore në 69 deklarata doganore, për vitin 2013 sipas aneksit nr. 4 bashkëlidhur raportit.

3. Vlera prej **2,739,762 lekë**, nga 35 subjekte sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore në 53 deklarata doganore, për vitin 2012 sipas aneksit nr. 5 bashkëlidhur raportit.

4. Vlera prej **7,766,205 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 87-98 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 17 deklarata doganore për vitin 2012 dhe në 8 deklarata doganore për vitin 2013, për artikullin banane, sipas aneksit nr. 6 bashkëlidhur raportit.

5. Vlera prej **8,076,985 lekë**, nga 13 subjekte sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për klasifikim të artikujve jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave, në 3 deklarata doganore, për vitin 2012 dhe në 19 deklarata doganore për vitin 2013, sipas aneksit nr. 7, bashkëlidhur raportit.

6. Vlera prej **3,567,176 lekë**, nga 8 subjekte sipas trajtimit në faqet 118-123 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për përcaktimin e origjinës së mallrave jo në përputhje me dokumentet shoqëruese sipas

kërkesave dhe kriterëve ligjore, në 10 deklarata doganore, për periudhën 2012-2013, sipas aneksit nr. 8, bashkëlidhur raportit.

7. Vlera prej **7,683,224 lekë**, nga 25 subjekte sipas trajtimit në faqet 130-150 të raportit për penalitete mbi kundërvajtjet administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv e pasiv të mallrave sipas KD, në 24 autorizime të audituara për periudhën 2011-2013 sipas aneksit nr. 9 bashkëlidhur raportit.

8. Vlera prej **650,000 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 127-129 të raportit për penalitete mbi kundërvajtjet administrative të evidentuar në magazinën e lirë doganore për mosrespektimin e afatit të qëndrimit në magazinë dhe për mos mbyllje të regjimit doganor për 7 raste, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256/1/256/4, 272/2, 275/2 dhe 287/2/F të KD, për periudhën 2012-2013.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe nr. 152/2013, për nëpunësit civil të Degës Doganës, Tiranë, **per 8 punonjes** si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
2. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
3. Për [REDAKTUAR] me detyrë, ish-Doganier
4. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
5. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
6. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
7. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Doganier klasifikim, vlerësim, kontroll fizik,
8. Për [REDAKTUAR] me detyrë, ish-Doganier.

-Për mospërputhjet e konstatuara në sektorin e klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit në deklaratat doganore të shoqëruara me mungesë të ardhurash në detyrime doganore dhe mosaplikim të penaliteteve sipas KD.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 275.1 dhe 287.2/f të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i është kërkuar Kryetarit të Degës Doganës, Tiranë të fillojë procedura për të vendosur gjobë në masën nga **50,000 deri në 200,000 mijë lekë** për **5 agjencitë doganore** me mospërputhje në deklaratat doganore të shoqëruara me mungesë të ardhurash në detyrime doganore dhe mos aplikim të penaliteteve sipas KD.

Shënim: Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **për 27 ish-punonjës** nuk janë rekomanduar masa, pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, p/grupi, Vladimir Rizvani, Bashkim Shehu, Sali Agaj, Anesti Gjika, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Tiranë, me shkresën nr. 11/22, datë 15.07.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se është hartuar një Program Masash në zbatim të rekomandimeve të KLSH ku janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e masave organizative dhe për shpërblim dëmi të propozuara. Nuk janë zbatuar ende masat disiplinore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT